



Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen e 41-të, të mbajtur më 14 prill 2016, mori:

## V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa nr. 419/15, datë: 30.09.2015 e BPrAL Kolegji "Iliria" për riakreditim të programeve të studimit:

- Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA (180 ECTS)
- Banka, Financa dhe Kontabilitet, MA (120 ECTS)
- Menaxhment dhe Informatikë, MA (120 ECTS)
- Menaxhment Shëndetësor, MA (120 ECTS)
- Juridik i Përgjithshëm, LLB (240 ECTS)
- Juridik Civil, LLM, (60 ECTS)
- Shkenca Kompjuterike - Informatikë e Aplikuar, BSc (180 ECTS)

## Arsyetimi

BPrAL Kolegji "Iliria" ka parashtruar kërkesë pran Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për riakreditim të programeve të studimit: Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA (180 ECTS); Banka, Financa dhe Kontabilitet, MA (120 ECTS); Menaxhment dhe Informatikë, MA (120 ECTS); Menaxhment Shëndetësor, MA (120 ECTS); Juridik i Përgjithshëm, LLB (240 ECTS); Juridik Civil, LLM, (60 ECTS); Shkenca Kompjuterike - Informatikë e Aplikuar, BSc (180 ECTS).

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur me 14 prill 2016 ka vlerësuar aplikacionin e BPrAL Kolegji "Iliria", dhe pas shqyrtimit të dosjes së stafit akademik duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ nr.02/2013, datë: 16.01.2013, neni 11, pika 3.2, ku sipas kësaj pike, institucioni duhet të ketë të paktën tre PhD (Dr.sc.) në marrëdhënie të rregullt pune për secilin program studimi, dhe në pajtim me nenin 13,

pika 1.1 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.02/2013, datë: 16.01.2013, KSHC ka refuzuar aprovimin e aplikacionit të BPrAL Kolegji "Iliria".

Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të ofruar nga BPrAL Kolegji "Iliria", KSHC konstaton se ka mungesë të stafit akademik me dokumentacion të rregullt për këto programe të studimit me të cilat ka aplikuar për ri-akreditim, dhe si rrjedhojë e kësaj gjendje, KSHC mori vendim për refuzim të aplikacionit të BPrAL Kolegjit "Iliria" për programet e cekura më sipër.

Edhe për kundër mundësisë së dhënë nga AKA (njoftimin përmes e-mailit datë: 14.03.2016) për plotësimin e dosjes së stafit akademik nga BPrAL Kolegji "Iliria", për programet e cekura më sipër, ky i fundit nuk ka përmbushur kriteret sipas nenit 11. pika 3.2 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim nr.02/2013.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet këtij organi në afatin prej 30 ditëve siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji "Iliria";
- Arkivit të AKA-së.

  
Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

